



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,
Ref:02.08.2017\560-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër Kosovës Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Zgjedhjet lokale nën hijen e Devollizmit", botuar më 27 korrik 2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet pjesërisht

A R S Y E T I M I

Në ankesë kundërshtohet shkrimi i cili pohon se "lidhja kriminale me nëntokën dhe mafinë ku prinë vëllezërit Devolli..."

KMShK konstatoi se akuzat pa fakte nuk sqarojnë por krijojnë më shumë huti. Gazeta është dashur që të gjejë fakte konkrete në mënyrë që t'i mbështesë pohimet e veta, për të cilat pretendon se janë të vërteta lidhur me Devollët.

Në këtë mënyrë gazeta ka bërë shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës). Gjithashtu, gazeta Kosova Sot nuk ka bërë asnjë përpjekje që të kërkojë prononcimin e palës tjetër, pra Devollëve, ose të një organi shtetëror apo ndonjë burimi të pavarur me çka do të plotësohej mozaiku i temës. Në këtë mënyrë gazeta ka shkelur Kreun IV (E drejta për t'u përgjigjur).

Opinionin u nxor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionin.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës